

1 E premte, 4 mars 2022

2 [Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

5 --- Fillon në orën 14.30

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita dhe mirë se erdhët
7 të gjithë, brenda dhe jashtë sallës.

8 Znj. Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar
10 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-04, Prokurori i
11 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.
13 Sekretare.

14 U lutem palëve dhe pjesëmarrësve të prezantohen duke
15 filluar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.

16 Z. Prokuror keni fjalën.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëdita i nderuar Gjykatës.
18 Sot Prokuroria prezantohet nga Alex Whiting, Zëvendësprokuror
19 i Specializuar; Margaux Portier, Punonjës për Nxjerrjen; Artur
20 Sirbu, Nëpunës Juridik; Moira van de Poel, stazhiere; dhe unë.
21 Filippo de Minicis, Prokuror.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 I kthehem Mbrojtjes.

24 Z. Gilissen.

25 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëdita i nderuar Gjykatës.

1 Përshëndes edhe kolegët, përfshirë dhe z. Simon Laws, të
2 cilin e shohim për herë të parë, pra, njihemi sot dhe të
3 gjithë të tjerët që janë të pranishëm në sallë dhe në galerinë
4 e publikut.

5 Jam Jean Louis Gilissen, Mbrojtës i z. Shala i cili sot
6 paraqitet përmes videolidhjes. Si zakonisht në sallë kam z.
7 Aouini, bashkëmbrojtës. Asistohemi nga znj. Dzaneta Petravica
8 dhe nga një kolege tjetër.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

10 Vë re se z. Shala ka hequr dorë nga e drejta për të qenë i
11 pranishëm brenda në sallë, por e përcjell këtë seancë përmes
12 videolidhjes.

13 Tani edhe Mbrojtësit të Viktimave.

14 Z. LAWS: [Përkthim] [përmes videolidhjes] Mirëdita i
15 nderuar Gjykatës. Mirëdita të gjithëve. Jam Simon Laws, jam
16 Mbrojtësi i caktuar për të përfaqësuar viktimat në këtë
17 çështje gjyqësore.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

19 Zyra Administrative.

20 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëdita, jam Jonas Nilsson,
21 përfaqësoj Zyrën Administrative.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Për procesverbalin, jam Nicolas Guillou, Gjykatës i
24 procedurës paraprake për këtë çështje gjyqësore.

25 Më 9 shkurt caktova datën e kësaj konference të gjashtë

1 për ecurinë e çështje. Për objektiv sot kam që të shqyrtojmë
2 ecurinë e kësaj çështjeje dhe të fillojmë përgatitjet për
3 kalimin e dosjes gjyqësore Trupit Gjykues. Në veçanti do të
4 diskutojmë për nxjerrjen, për përkthimet, për ecurinë e
5 hetimeve të Prokurorit të Specializuar, ecurinë e hetimeve të
6 Mbrojtjes, pikat juridike dhe faktike për të cilat palët
7 pajtohen dhe në fund ndonjë problem të cilët palët dëshirojnë
8 që të ngrenë.

9 Falënderoj ZPS-në dhe Mbrojtjen për parashtrimet e bëra
10 paraprakisht kësaj konference për ecurinë e çështje. Si
11 zakonisht u kërkoj palëve që të flasin në mënyrë koncize për
12 secilën pikë të trendit të ditës, të cilat do ti marr veçmas.

13 Por përpara se të fillomë ne rendin e ditës, dëshiroj që
14 të diskutojmë dy aspekte paraprake.

15 E para ka të bëjë me kërkesën e fundit të Mbrojtjes për
16 shtyrje të afatit kohor për parashtrimet për paraburgimin që
17 është parashtrimi i protokolluar me numër F160. Rikujtoj se në
18 përputhje me vendimin e Gjykatës së Apelit të datës 11 shkurt
19 2022, i kam kërkuar Mbrojtjes që të bëjë kërkimet e veta sa i
20 takon gatishmërisë dhe kapacitetet të Mbretërisë së Belgjikës
21 për të vënë në zbatim ndonjë kusht lirimi të cilin e ka
22 propozuar dhe/ose kushte të tjera shtesë.

23 Në të njëjtin vendim, e kam urdhëruar Mbrojtjen që të
24 dorëzojë parashtrimet e veta për rishikimin e ardhshëm të
25 paraburgimit të z. Shala jo më vonë se data 2 mars 2022.

1 Lidhur me këtë vërej se Mbrojtja ka kërkuar shtyrje prej 4
2 javësh për dorëzimin e parashtrimeve të veta për rishikimin e
3 ardhshëm të paraburgimit të z. Shala për të siguruar dhe
4 vlerësuar qëndrimin e qeverisë belge si dhe për të dhënë
5 qëndrimin e vet të Mbrojtjes për këto aspekte.

6 Së pari i lutem ZPS-së të bëjë parashtrime nëse ka lidhur
7 me këtë.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.
9 Prokuroria nuk ka kundërshtim për kërkesën e Mbrojtjes për
10 ta shtyrë afatin për dorëzimin e parashtrimit të tyre.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

12 Z. Aouini a keni ndonjë gjë për të shtuar, por pa
13 përsëritur ato që ju keni bërë në parashtrimet me shkrim
14 tashmë.

15 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Mirëdita të gjithëve.

16 Desha të theksoj se ju keni marrë një përgjigje parapake
17 lidhur me aspektet logjistike. Duhet të përdorim kanalet e
18 ndryshme që janë të pranueshme nga Mbretëria e Belgjikës. Jemi
19 në proces të dërgimit të korrespondencës dhe besoj se qëndrimi
20 ynë do të jetë më i qartë para se të marrim përgjigjen
21 përkatëse.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Aouini.

23 Pasi dëgjova palët, lëshoj këtë urdhër të parë gojarisht.

24 Vërej se Mbrojtja nuk ka arritur ende të sigurojë
25 informacione dhe nuk ka bërë progres të kënaqshëm me kërkimet

1 e veta pranë autoriteteve belge.

2 Gjithashtu mendoj se informacioni dhe parashtrimet e
3 Mbrojtjes janë të nevojshme për të trajtuar vendimet e
4 Gjykatës së Apelit të datës 11 shkurt 2022 dhe për të
5 rishikuar paraburgimin e z. Shala.

6 Së fundi vërej faktin se ZPS-ja nuk ka kundërshtim për
7 shtyrjen e kërkuar të afatit.

8 Në këto rrethana mendoj se është treguar arsye e vlefshme
9 sipas kuptimit të rregullës 9(5)(a) të Rregullores për të
10 justifikuar shtyrjen e kërkuar.

11 Në këtë aspekt vërej gjithashtu se z. Shala ka hequr dorë
12 për rishikim të paraburgimit brenda afatit dy mujor të
13 parashikuar në nenin 41(10) të ligjit dhe në rregullën 57(2)
14 të Rregullores.

15 Rrjedhimisht urdhëroj Mbrojtjen të dorëzojë parashtrimet
16 jo më vonë se e mërkura, 30 mars 2022. Përgjigja dhe
17 kundërpërgjigja do të dorëzohen sipas afatit të parashikuar në
18 rregullën 76 të Rregullores.

19 Këtu mbyllet ky urdhër i parë lëshuar gojarisht.

20 Aspekti i dytë që dëshiroj të diskutoj është kërkesa e
21 Mbrojtësit të Viktimave që është parashtrimi i protokolluar me
22 numër F151.

23 Për këtë znj. Sekretare, ju kërkoj të kalojmë në seancë
24 private.

25 [Gjykatësi dhe Sekretarja konsultohen]

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Laws, informohem se për
2 shkak të faktit se ju merrni pjesë në distancë, fatkeqësisht
3 ju nuk mund ta ndiqni seancën private dhe kjo është
4 problematike se kjo ka të bëjë me kërkesën që ju keni bërë me
5 parashtrimin e protokolluar F151.

6 Kështu që [unë] nuk mund t'jua jap fjalën, sigurisht, por
7 mbase ju nuk keni nevojë të shtoni informacion për këtë
8 parashtrim të protokolluar. Unë vetëm mund të pyes palët, nëse
9 kanë ndonjë gjë për t'ju përgjigjur kësaj. Vetëm se këtë
10 diskutim nuk do ta bëjmë sot, do ta bëjmë me parashtrime me
11 shkrim. Nëse nuk ka ndonjë gjë për t'u përgjigjur, atëherë
12 mund të jap një urdhër të lëshuar gojariht. Mund t'i jap nja
13 dy minuta palëve që t'i hedhin një sy parashtrim të
14 protokolluar.

15 Z. Prokuror, shumë shkurt nëse keni koment të përgjithshëm
16 për këtë. Dhe nëse keni do të thotë se nuk do të vazhdojmë.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ne mbështesim masën e kërkuar
18 nga Mbrojtësi i Viktimave.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

20 Z. Gilissen.

21 Z. GILISSEN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ia lëmë të
22 nderuarit Gjykatës vendimmarrjen.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gilissen.

24 Falënderoj palët. Do të kaloj tani në seancë private. Do
25 t'i kërkoj Zyrës Administrative që të mbajë transkriptin në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes (~~Seancë private~~) Pursuant to instructions of Pre-trial Judge CRSPD#21 reclassified to PUBLIC Page 7

1 dispozicion për z. Laws.

2 [Seancë private] Pursuant to instructions of Pre-trial
Judge CRSPD#21 reclassified to PUBLIC

3 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës jemi
4 në seancë private dhe audio për z. Laws nuk është aktive.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

6 Do të lëshoj tani urdhrin e dytë gojarisht.

7 Duke mbajtur parasysh se viktimat pjesëmarrëse në procesin
8 gjyqësor konfirmon se kërkon anonimin kundër të akuzuarit dhe
9 Mbrojtjes urdhëroj vijimin e zbatimit të masave mbrojtëse
10 sipas rregullës 80(4)(d) dhe (e)(i) të Rregullore për arsyet e
11 identifikuar në paragrafët 37 deri 40 të vendimit tim të
12 datës 15 dhjetor 2021, pa cenuar ndryshimin e këtyre masave në
13 një fazë të mëposhme, përfshirë edhe nga Trupi Gjyqësor nëse
14 dhe kur do të lindë nevoja.

15 Gjithashtu, Mbrojtësi i Viktimave të dorëzojë një version
16 të redaktuar publik të parashtrimit të protokolluar me numër
17 F151 dhe këtë ta bëjë pa vonesë.

18 Këtu mbyllet ky urdhrë i dytë i lëshuar gojarisht.

19 Znj. Sekretare mund të rikthehem në seancë publike.

20 [Seancë e hapur]

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës jemi
22 rikthyer në seancë publike.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj. Sekretare.

24 Kalojmë tani tek tema e parë që është përcaktuar në
25 urdhrin e caktimit të datës së konferencës për ecurinë e

1 çështjes që ka të bëjë me nxjerrjen.

2 Do t'i jap fjalën palëve për nxjerrjen e secilës kategori
3 të materialit provues si zakonisht, duke filluar me materialin
4 e rregullës 102(1)(b) që është materiali të cilin ZPS-ja synon
5 ta paraqesë në gjykim; materiali i rregullës 102(3) që është
6 material i rëndësishme për çështjen gjyqësore siç është
7 përmendur nga ZPS-ja; materiali i rregullës 103 që është
8 materiali shfajësues; materiali i rregullës 107 që është
9 materiali i mbrojtur për të cilin nevojitet dhënia e
10 autorizimit të dhënësit të informacionit.

11 Përpara kësaj, vërej se paketa e nxjerrjes me numër 36 që
12 është nxjerrë nga ZPS-ja më 23 shkurt 2022 nuk përmban asnjë
13 dokument.

14 I lutem ZPS-së që të shpjegojë arsyet përse u bë një
15 nxjerrje pakete e zbrazët që ta kemi për procesverbalin.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Patjetër.

17 Siç e kemi informuar Mbrojtjen tashmë, ne nuk kemi nxjerrë
18 më përpara dy materiale që janë nxjerrë në janar. I kemi
19 tërhequr më saktë, nxjerrën e dy materialeve që i kishim
20 nxjerrë në janar. Tërheqja siç e kuptojnë ne e këtij
21 materiali, ka nxitur në sistemin *Legal Workflow*, nxjerrjen e
22 kësaj pakete të zbrazët.

23 Domethënë ne nuk kishim ndërmendt që të përfshinim ndonjë
24 gjë aty. Thjesht tërhoqëm materiali. Kjo ishte pasoja teknike
25 e veprimit tonë.

1 Shpresoj që t'i jem përgjigjur pyetjes.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra qenka një funksion i
3 sistemit *Legal Workflow* ky.

4 Z. Nilssen keni ndonjë shpjegim duke qenë se ju jeni
5 personi më i familjarizuar me *Legal Workflow*.

6 Z. NILSSON: [Përkthim] Po të isha unë ai që jam ustai i
7 *Legal Workflow* në këtë sallë do të ishte problem. Por jo nuk
8 di ç'të them lidhur me këtë, fatkeqësisht.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mbase mund të monitoroni, ta
10 ndiqni këtë çështje në vijimësi, për të parë nëse mund të
11 rregullohet ky lloj funksioni në të ardhmen, sepse nuk ka
12 kuptim që të bëhet nxjerrja e paketave të zbarëta.

13 Z. NILSSON: [Përkthim] Patjetër i nderuar Gjykatës, do ta
14 ndjekim këtë çështje.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Nilsson.

16 Kalojmë tani te materiali të cilin ZPS-ja synon ta përdorë
17 në gjykim.

18 Kisha kujtuar se këtë kategori nxjerrjeje e kishim
19 përfunduar, por me sa duket nuk është kështu, sepse më 17
20 shkurt 2021 ZPS-ja dha njoftim nxjerrjeje për një material të
21 ri që bën pjesë në rregullën 102(1)(b) dhe gjithashtu kërkoi
22 leje për ta shtuar këtë material në listën e materiale të
23 cilat do t'i përdorë në gjykim.

24 Më 2 mars Mbrojtja ka bërë të ditur se nuk ka kundërshtim
25 për kërkesën, por se si pasojë e nxjerrjes me vonesë i duhet

1 që të vlerësojë materialin që ka përpunuar tashmë, e cila
2 shkakton vonesë në përgatitjen e lëndës së vet.

3 Mbrojtja gjithashtu vëren se rezervon të drejtën për të
4 kërkuar masën e duhur për cenimin që ka pësuar si rezultat i
5 nxjerrjes me vonesë.

6 Që në fillim vë re se afati kohor për nxjerrjen e
7 materialit sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores ka
8 përfunduar. Pra, në vend që ta nxirrte këtë material ZPS-ja
9 fillimisht duhej të kishte kërkuar leje për këtë gjë.

10 Palët nuk mund të vendosin me kokën e tyre afatin. Kemi
11 një kornizë ligjore të cilën unë kam ndërmend që ta zbatoj.

12 I kërkoj ZPS-së që të rikujtojë parashtrimet e veta dhe i
13 kërkoj Mbrojtjes që të përgjigjet. Së pari ZPS-ja nuk ka
14 nevojë që të kalojmë në seancë private për ta trajtuar këtë
15 çështje?

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk mendoj se do të jetë e
17 nevojshme. Besoj se mund t'i bëj parashtrimet e mia në seancë
18 publike.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirë në rregull vazhdoni.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do ta trajtoj shkurt këtë. Por
21 që në fillim dëshiroj që të vërej bashkëpunimin e frytshëm
22 *inter partes* që kemi pasur me Mbrojtjen pas konferencës së
23 fundit për ecurinë e çështjes. Falë komunikimeve të shpeshta,
24 të çiltra dhe të hapur dhe falë profesionalizmit të Mbrojtjes
25 ia kemi dalë mbanë që të zgjidhim shumë probleme *inter partes*.

1 Ne mendojmë që do të vazhdojmë që ta bëjmë këtë gjë, ndërkohë
2 që faza paraprake do ja lerë vendin fazës së gjykimit.

3 Tani t'i kthehemi pyetjes tuaj. Prokuroria është në dijeni
4 të afate të cilat i ka vendosur i nderuar Gjykatës, përshirë
5 këtu afatet për nxjerrjen e materialeve sipas rregullës
6 102(1). Në fakt ka qenë detyrimi unë për ta nxjerrë këtë
7 material, por siç e kemi shpjeguar, ky dokument i shkruar me
8 dorë është përkthyer dhe përpunuar për nxjerrje me t'u bërë e
9 dukshme që raporti që kishim nxjerrë lidhur me këtë shënim të
10 mbajtur me dorë nuk përmbante të gjithë informacionin që
11 përmbanin këto shënime.

12 Është një situatë tejet e pazakontë, i nderuar Gjykatës,
13 sepse këto shënime të mbajtura me dorë janë procesverbali
14 fjalë për fjalë i takimit të parë që personeli i TFHS-së ka
15 zhvilluar me atë dëshmitar. Në këtë situatë domethënë ne nuk e
16 prisnim këtë gjë.

17 Domethënë, mbasi ju bëmë një shqyrtim shënimeve të këtij
18 procesverbali, si të thuash, i krahasuam me atë që kishim
19 nxjerrë, e kuptuam që i detyroheshim Mbrojtjes më shumë
20 informacion të cilin e kishim në këto shënime të mbajtura me
21 dorë, prandaj dhe ia nxorëm pa kërkuar leje.

22 Por ne e kuptojmë preferencën, i nderuar Gjykatës, që në
23 fillim duhet të kërkojmë lejen dhe pastaj të bëjmë nxjerrjen.
24 Dhe sigurisht kështu do të veprojmë.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

1 Z. Gillisen.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit z. Kryetar, nxjerrja
3 sipas rregullës 102(1)(b) -- kemi marrë nxjerrjen e disa prej
4 materialeve të mbajtura nga ZPS-ja që nuk i kishin nxjerrë.
5 Janë 12 materiale të mbuluara nga vendimi i 12 korrikut 2021
6 dhe ende presim dy prej tyre. Mund të them që në fillim se do
7 të na duhet që të rivlerësojmë nevojën -- duhet rivlerësuar
8 nevoja për mosnxjerrjen e këtyre materialeve për të evituar
9 probleme, vështirësi deri 30 ditë para gjykimit se mund të
10 dalin gjëra të reja, prandaj dua që ta shmangin këtë
11 vështirësi.

12 Këtu kam ardhur tek pika e dytë që dua të cek. Ka të bëjë
13 me nxjerrjen e deklaratave të mëparshme të dëshmitarit. Ne nuk
14 ishim kundër shtimit në listën e provave materiale të këtyre
15 materialeve, sepse pavarësisht se është një nxjerrje me shumë
16 vonesë ne besojmë se ky dokument do të jetë me rëndësi për
17 Mbrojtjen. Por duhet të vërejmë se ky shtim me vonesë në
18 listën e provave materiale duhet të trajtohet me vëmendje të
19 madhe.

20 Është realitet, i nderuar Gjykatës, që ne ndodhemi
21 gjithmonë në situatën ku na duhet të rivlerësojmë këto
22 deklarata të mëparshme, parë nga drita e deklaratave të tjera
23 që i kemi marrë përpara, lidhur me këtë dëshmitar. Dhe unë
24 dëshiroj që të gjithë ta kuptojnë që do ta cenonte pozicionin
25 e Mbrojtjes sa i takon përgatitjes efikase për gjykimin.

1 E fundit që dua të them për këtë çështje është se i lutem
2 fuqimisht ZPS-së që ta shqyrtojë me vëmendje materialin për
3 nxjerrjen sipas rregullës 103 sepse ne besojmë se këto
4 materiale do të duhet të ishin nxjerrë si material shfajësues
5 në një fazë edhe të mëparshme. Kjo do të kishte qenë më mirë
6 për organizimin dhe më vjen keq që i kthehem gjërave që i kam
7 thënë më përpara, por i kuptoj vështirësitë me të cilat
8 përballen të gjitha palët.

9 Faleminderit i nderuar Gjykatës.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Gilissen kërkoni ndonjë
11 mjet zgjidhës.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ajo çfarë është bërë është bërë
13 z. Kryetar. Thjesht na duhet që të marrim dokumentet në kohën
14 e duhur dhe sipas procedura të përcaktuara.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gilissen.

16 Z. Prokuror doni të përgjigjeni.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Shkurtimisht i nderuar
18 Gjykatës.

19 Ne nuk e pranojmë që cenimi apo paragjykimi që citoi
20 avokati është pozicioni ynë. Domethënë ne nuk pranojmë që ka
21 ndonjë cenim apo paragjykimi nga ana jonë.

22 Ndërkohë që shënimi për këtë takim është bërë me dije,
23 raporti është dhënë Mbrojtjes.

24 Ndërkohë që është e vërtetë që shënimet, raportet e
25 mbajtura me shkrim kanë më shumë informacion, megjithatë këto

1 kanë të bëjnë me informacione të cilat kanë të bëjnë me
2 deklarata të tjera të këtij dëshmitar.

3 I nderuar Gjykatës këtu flasim për hollësi, nuk është se
4 po flasim për fakte të reja apo nuk flasim për ndryshim kursi
5 të çështjes së Prokurorisë. Kështu që kur flasim për
6 paragjykim nga ana jonë jemi disi skeptikë dhe e kemi paksa
7 problem këtë lloj formulimi dhe e rrëzojmë e kundërshtojmë
8 këtë propozim në adresën tonë.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Aouini, të lutem shumë
10 shkurtimisht.

11 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

12 Neve nuk e pranojmë njohjen e paragjykimit dhe mund t'ju
13 tregojmë, mund t'ju themi z. Gjykatës, që në këtë moment ju
14 identifikojmë që kemi të paktën tri fakte të veçante ose
15 elementë të veçantë të cilët neve nuk i kemi parë, nuk i kemi
16 hasur në deklarata të tjera të mëparshme.

17 Z. Gilissen tha se ne besojmë dhe kjo është arsyeja që
18 pse neve duam që të shkurtet në procesverbal që ne nuk e
19 kundërshtuam këtë dokument për shtesën në listën e dokumenteve
20 provuese, por thamë që ky dokument është i rëndësishëm për
21 Mbrojtjen dhe i takon ZPS-së të vlerësoj apo rivlerësojë më
22 mirë në qoftë se ky është një informacion që duhet të nxirret
23 sipas rregullës 103.

24 Ne kemi deklarata të shumta na ky dëshmitar dhe në qoftë
25 se nuk kemi të gjithë panoramën e plotë, të gjithë elementët e

1 ndryshëm të kronologjisë dhe në qoftë se kemi vonesën e
2 nxjerrjes së informacion, në mes të informacion kjo na bën
3 neve që të jemi skeptikë dhe kjo nuk është detyrë e thjeshtë
4 dhe më duhet të them që paragjykimi është një pjesë e tij dhe
5 materiali i cili bie nën rregullën 103 duhej të ishte nxjerrë
6 shumë herë më përpara. Dhe sigurisht që ne nuk e pranojmë që
7 afati kohor duhet të ishte anashkaluar në nxjerrjen e
8 materialeve të cilat janë të rëndësishme për arsyen e
9 gjykimit.

10 Pra, kjo është e drejta jonë bazë, i nderuar Gjykatës. Në
11 momentin kur neve të vlerësojmë së bashku me gjërat e tjera
12 elementin e cenimit apo paragjykitimit si dhe ndikimin e
13 nxjerrjes së vonë, prapë do të doja të thoja që ky është një
14 fakt i veçantë, një fakt më vete. Dhe kemi disa dokumente
15 kështu që ky është konteksti i përgjithshëm dhe ky është
16 pozicioni ynë lidhur me këtë çështje i nderuar Gjykatës.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Aouini.

18 Pasi dëgjova palët, po lëshoj urdhrin e tretë gojariht.

19 Vërej se megjithëse materiali i nxjerrë rishtazi përmban
20 disa informacione shtesë, informacion parësore që përmbahen në
21 këtë material i janë vënë në dispozicion Mbrojtjes me anë të
22 një materiali të nxjerrë më parë në pajtim me afatet kohore
23 përkatëse.

24 Gjithashtu Mbrojtja nuk ka kundërshtim për këtë nxjerrje.

25 Krahas kësaj vërej se ZPS-ja ka nxjerrë vetëm një

1 material dhe se dosja e çështjes gjyqësore nuk i është kaluar
2 ende Trupit Gjykses.

3 Sa më lart mendoj se kjo i jep kohë të mjaftueshme
4 Mbrojtjes të vlerësojë këtë nxjerrje edhe pse ajo bën të ditur
5 se kjo do të shkaktojë vonesë.

6 Në këto rrethana specifike mendoj se nxjerrja e
7 materialit në një fjalë nga ZPS-ja para marrjes së autorizimit
8 gjyqësor nuk e ka cenuar mbrojtjen.

9 Gjithashtu miratoj kërkesën e ZPS-së për ta shtuar këtë
10 material në listën e materialeve në të cilat do të mbështeten
11 në gjykim.

12 Gjithashtu ZPS-ja të dorëzojë pa vonesë një version të
13 redaktuar publik të parashtimit të protokolluar me numër
14 F149. Pasi të marrë versionin publik të redaktuar dhe ky është
15 fundi i urdhrit të tretë gojarisht.

16 Z. Prokuror ia kam nënvizuar edhe në parë ZPS-së
17 domosdoshmërinë për të kërkuar autorizim gjyqësor lidhur me
18 aspekte që kanë të bëjnë me nxjerrjen. Theksoj se nuk do të
19 lejoj më probleme të nxjerrjes në lidhje me të cilat ZPS-ja
20 vepron me kokë të vetë pa kërkuar autorizim gjyqësor.

21 Shpresoj që kjo të jetë e qartë.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E kuptojmë i nderuar Gjykatës.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

24 Përpara se të kalojmë në materialin 102(3) dua t'u kërkoj
25 palëve në qoftë se kanë parashtime lidhur me rubrikat e reja

1 të dëshmitarëve të krijuara në *Legal Workflow*.

2 Në parashtrimin me shkrim ZPS-ja ka thënë që do të
3 fillojë të lidhë materialet sipas rregullës 102(1) me
4 dëshmitarët përkatës. Vë re që ky proces është në vijim e
5 sipër e do të përfundojmë përpara fillimit të gjykimit.

6 Mbrojtja ka thënë se këto rubrika në formën aktuale të
7 tyre janë pak të vlefshme sepse ato nuk e lidhin materialin e
8 nxjerrë me dëshmitarë të propozuar.

9 Dua t'u kërkoj palëve që të na thonë në qoftë se
10 diskutimet *inter partes* janë në vijim e sipër lidhur me këtë
11 temë dhe nëse Mbrojtja është e kënaqur me prezantimin e
12 rubrikave të dëshmitarëve në sistemin ligjor *Legal Workflow*
13 dhe me ritmin e lidhjes së ofruar nga ZPS-ja.

14 Dua të jap njoftim paraprak për palët që synon që të
15 përcaktoj një afat kohor për përfundimin e diskutimeve *inter*
16 *partes* mbi këtë çështje në fund të kësaj konference për
17 ecurinë e çështje.

18 Ftoj më tej Mbrojtjen të na thonë në qoftë se ata synojmë
19 të më drejtohen lidhur me këtë çështje.

20 z. Prokuror, ju lutem.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit i nderuar
22 Gjykatës.

23 Neve i qëndrojmë parashtrimeve me shkrim në kuptimin që
24 lidhja është në punë e sipër. Ne kemi pesë dëshmitarë të cilët
25 janë thujse gati për t'u nxjerrë me dokumentet dhe provat

1 materiale përkatëse dhe do ta bëjmë këtë gjë sa më shpejt të
2 jetë e mundur.

3 Kaq mund të them sa i takon përditësimit lidhur me këtë
4 çështje.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jam i sigurt se çfarë
6 pyetje do të bëj më pas.

7 Çfarë do të thonë "sa më shpejt të jetë e mundur" sepse
8 ju gjatë të gjithë kohë thoni "sa më shpejt të jetë e mundur"
9 kur flitet për ndonjë rregull apo rregullore dhe kjo nuk do të
10 thotë shumë dhe unë preferoj më tepër që të kem një numër.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës besoj se
12 jeni i kënaqur që të dëgjoni që sa më shpejt të jetë e mundur
13 do të thotë javën që vjen.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po jam i lumtur që e dëgjoj
15 këtë.

16 Z. Aouini.

17 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.

18 Sa për të konfirmuar që në datën e nxjerrjes së rubrikave
19 të dëshmitarëve, pra në datën që morëm këtë dosje bosh, në atë
20 moment neve kontaktuam ZPS-në dhe arritëm në përfundimin që jo
21 vetëm që do të vihen emrat, pra emrat e plotë, mbiemrat dhe
22 informacione të tjera që janë të rëndësishëm për dëshmitar,
23 por gjithashtu do të bëhet edhe lidhja ndërmjet dokumenteve
24 dhe këtyre subjekteve të dëshmitarëve që është qëllimi fundor
25 i një procesi të tillë.

1 E mirëpresim këtë informacion që do të marrim --
2 informacionin që iu referua Prokurori javën që vjen dhe mezi
3 presim ta marrim atë. Por jemi dakord që kjo është një çështje
4 me përparësi të lartë siç janë gjërat në këtë pikë.

5 Faleminderit.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Aouini.

7 Një tjetër pyetje për Prokurorinë. Ju thatë që dorëzimi
8 do të bëhet javën që vjen për pesë dëshmitarë. Po për
9 dëshmitarët e tjerë.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Për dëshmitar e tjetër i
11 nderuar Gjykatës nuk jam në pozitë që t'ju jap një ditë
12 specifike, por ne po punojnë në mënyrë intensive, pra po
13 punojmë vazhdim që të mund të lidhim informacionet me rubrikat
14 e dëshmitar dhe do t'ju japim informacionin sa më shpejt të
15 jetë e mundur. Kësaj radhe sa në fakt sa i takon formulimit
16 "sa më shpejt të jetë e mundur" nuk është se kam ndonjë
17 përcaktim konkret.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

19 Në qoftë se mund ta mbani të informuar Mbrojtjen për
20 ritmin e lidhjes do ta vlerësonim shumë në mënyrë që Mbrojtja
21 ta marrë këtë gjë parasysh dhe në qoftë se kanë koment, si sa
22 i takon lidhjes, por gjithashtu edhe ritmit të punës ata mund
23 t'ju drejtohen.

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po patjetër do t'ju informojmë.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

1 Tani le të kalojmë tek nxjerrja e materialit të provues
2 që lidhet me rregullën 102(3). ZPS-ja ka thënë në parashtimet
3 me shkrim që ka nxjerrë të gjithë materialet që bien nën
4 fushën e veprimit të rregullës 102(3) që janë kërkuar, nga
5 Mbrojtja me përjashtimin e dokumenteve të cilët janë përfshirë
6 në kërkesat pezull për masa mbrojtëse dhe dokumente që bien
7 nën rregullën 107.

8 Duke qenë se unë kam dhënë urdhër për dy masa mbrojtëse
9 të cilat, pra urdhër që është dhënë më herët gjatë kësaj, do
10 të ftoja ZPS-në që të konfirmonte që nxjerrjen e dokumenteve
11 që bien nën rregullin 107 dhe dokumentet e tjera për të cilat
12 kam vendosur -- kam marrë vendim në kuadrin e vendimit tim për
13 rregullin 102(3) që janë kërkuar nga Mbrojtja dhe që do të
14 bëhen të disponueshme.

15 Në parashtim me shkrim Mbrojtja tregon se palët po bëjnë
16 përpjekje për të zgjidhur të gjitha problemet *inter partes* dhe
17 këtu e ka fjalën për problemet që kanë të bëjnë me nxjerrjen e
18 materialeve. Megjithatë Mbrojtja përsërit shqetësimin e saj
19 lidhur me pamjaftueshmërinë e përshkrimit të disa prej
20 dokumenteve të listuara në rregullën 102(3) dhe në dokumentet
21 e nxjerra nga Prokuroria sipas këtij rregulli.

22 Gjithashtu vërej se është e rëndësishme që do të duhet që
23 të mund të vijohet me diskutimet *inter partes* gjë të cilën e
24 ka nënvizuar ZPS-ja për të sqaruar diskutimet për disa
25 dokumente rast pas rasti.

1 I mirëpres këto diskutime *inter partes* por ato nuk mund
2 të zgjasin gjithmonë. Nxjerrja sipas materialit sipas
3 rregullës 102(3) ka thujse një gjysmë viti që vijon dhe tani
4 ka ardhur koha që t'i japim fund këtyre diskutimeve.

5 Tani dua ti jap njoftim paraprak palëve që planifikoj që
6 të përcaktoj një afat për parashtrimin e kërkesave lidhur me
7 procesin e nxjerrjes së materialeve. Ftoj më tej Mbrojtjen të
8 thonë në qoftë se dëshirojnë të dorëzojnë ndonjë kërkesë sa i
9 takon përshkrimin të dokumenteve të përmendura në njoftimin e
10 rregullës 102(3) ose për të kërkuar dokumente të tjera në
11 procesin e nxjerrjes.

12 Zoti Prokuror fjala për ju.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit i nderuar
14 Gjykatës.

15 Sa i takon nxjerrje së dokumenteve në listën sipas
16 rregullës 102(3) mund të konfirmoj që do të nxjerrim
17 dokumentet të cilat janë trajtuar në vendimin tuaj, i nderuar
18 Gjykatës; e sipas afateve dhe mënyrës së përcaktuar në këtë
19 vendim.

20 Ka disa dokumente sipas rregullës 107 të cilat do t'i
21 diskutojmë pak më vonë në agjendën e ditës së sotme. Por ato
22 do të shtohen tani që kemi më të qartë se si lidhur me listën
23 e 102(3) pra pasi kemi kërkuar leje për ta bërë këtë gjë.

24 Kemi konstatuar gjithashtu një tjetër dokument që është
25 një dokument i cili nuk bie nën rregullin 107 që është kërkuar

1 nga Mbrojtja, por të cilin ne nuk e kemi nxjerrë. Mbrojtja
2 është informuar ja kemi thënë pra mbrojtja më përpara dhe do
3 ta nxjerrim këtë dokument sa më shpejt të jetë e mundur. Është
4 një dokument i cili është në gjuhën serbe dhe ne do t'i japim
5 një version të përkthyer të tij dhe do ta nxjerrim atë pa
6 vonesa të mëtejshme.

7 Lidhur me përshkrimet që kanë të bëjnë me dokumentet në
8 listën sipas rregullit 102(3).

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Prokuror përpara se të
10 kalojmë te përshkrimi, ju lutem a mund të na thoni që ka
11 ndonjë arsye se pse është vonuar nxjerrja e këtij dokument dhe
12 e dyta a mund të konfirmoni që nuk e diskutoni materialitetin
13 për Mbrojtjen.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Konfirmoj që nuk kemi ndonjë
15 mosmarrëveshje lidhur me këtë dhe arsyeja për vonesën në
16 nxjerrjen e dokument është çështja e përkthimit.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

18 Mund të vazhdoni më tej me përshkrimin.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Sa i takon përshkimit, i
20 nderuar Gjykatës, si pasojë e diskutimeve shtesë me Mbrojtjen
21 ne kemi arritur një marrëveshje. Ne do të rishikojmë
22 dokumentet sipas listës së rregullës 102(3) që nuk janë
23 kërkuar deri tani nga Mbrojtja ose që nuk i janë nxjerrë
24 Mbrojtjes deri tani si për shembull në pajtim me rregullim
25 102(3). Pra ne do ta fillojmë këtë punë pa vonesë, do ta

1 vazhdojmë këtë punë pa vonesë dhe do të jemi në pozitë t'iu
2 informojmë sigurisht kur kërkoni, pra një listë të rishikuar
3 të përshkrimeve për këtë dokumente që janë pezull.

4 Ne besojmë që deri në fund të javës që vjen, do të jemi
5 në gjendje që të japim një informacion goxha të saktë lidhur
6 me kohën se kur mund të t'ia japim këto përshkrime të
7 rishikuara Mbrojtjes.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

9 Z. Gilissen. Fjala për ju.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit z. Kryetar.

11 Sa i takon nxjerrjes së materialeve sipas rregullës
12 102(3) ne mund të themi që i kemi përzgjedhur dokumentet dhe i
13 kemi marrë të gjitha dokumentet. I kemi marrë të gjitha këto
14 dokumente në paketën 32, më 8 shkurt 2022.

15 Ajo çfarë mbetet ende për t'u nxjerrë, siç e thatë dhe
16 juve, janë materialet që janë përzgjedhur dhe për të cilat
17 janë dhënë masa mbrojtëse.

18 Më duhet të them që kemi pasur diskutime të frytshme
19 ndërmjet palëve *inter partes* dhe siç e tha edhe kolegu nga
20 ZPS-ja ne jemi duke diskutuar përshkrimet e dokumenteve, kjo
21 është një çështje e madhe, sigurisht. Por po diskutojmë edhe
22 për gjëra të tjera. Por ne do të vazhdojmë që t'ju japim një
23 panoramë të situatës ashtu siç janë ato. Mendoj se jemi në
24 rrugën e drejtë sa i takon kësaj çështje.

25 Faleminderit.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Gilissen, a mund të
2 konfirmoni ju lutem që nuk keni më kërkesa që bien nën
3 rregullën 102(3) nga njoftimi që ju ka dërguar Prokuroria?

4 Z. Aouini ju lutem.

5 Z. AOUINI: [Përkthim] Thjesht një çështje teknike. Pas
6 diskutimeve që kemi pasur sot me kolegët e ZPS-ë që na
7 informuan që do të rishikojnë dokumentet të cilat ne nuk kemi
8 përzgjedhur, domethënë kjo është çështje që ne e kemi
9 diskutuar pas konferencën së fundit për ecurinë e çështjes.

10 Sigurisht i lëvdojmë kolegët tanë për arsyeshmërinë dhe
11 për mirësjelljen e treguar në raport me kërkesën tonë, gjë e
12 cila është e drejtë. Ne kemi vijuar me listën e shembujve duke
13 ju treguar atyre pse kemi nevojë për hollësi për dokumente të
14 caktuara.

15 Tani që kemi marrë përshkrime të reje për dokumentet që
16 nuk janë përzgjedhur, ne na duhet që të na lejohet ca kohë
17 sepse këtë donim të mënjanonim, domethënë që të mos merrnim
18 dokumente për shkak të mungesës së përshkrimit.

19 Do na duhet ca kohë lidhur me këtë rishikim dhe në kohën
20 kur të marrim përditësime të reja besoj që ky duhet të jetë
21 afati kohor që duhet marrë si bazë sa i takon përzgjedhjes nga
22 ana jonë.

23 Sa i takon listave plotësuese ne kemi vepruar me
24 shpejtësi nga ana jonë.

25 Faleminderit.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull.

2 Z. Prokuror a mund të na thoni se kur do të keni mundësi
3 t'i jepni Mbrojtjes një listë të përditësuar.

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Do të jemi në gjendje të japim
5 një vlerësim të tillë kur të fillojmë të punojmë me rishikime
6 të tilla dhe kur të kemi një gjykim të përgjithshëm se çfarë
7 ritmi mund të ndjekim për bërjen e rishikimeve të tilla.

8 Pra siç e thashëm edhe më lart deri në fund të javës që
9 vjen do të jemi në gjendje që të japim një vlerësim të saktë
10 dhe do të jemi të lumtur që t'ju informojmë edhe juve, i
11 nderuar Gjykatës, në qoftë se do të doni të informoheni prej
12 nesh.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra, deri në fund të javës
14 do më informoni mua, Prokurori -- dhe Mbrojtjen, pra mua dhe
15 Mbrojtjen se kur do të jeni në gjendje për të përfunduar këtë
16 proces.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, bëhet
18 fjalë për rreth 17 -- për disa qindra dokumente të cilat nuk
19 janë kërkuar nga Mbrojtja dhe do të na duhet ca kohë në fakt
20 dhe do të duhet që të marrim parasysh situatën, ritmin e punës
21 dhe të vlerësojmë kohën që nevojitet nga detyra në fjalë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

23 Z. Aouini, z. Gilissen, sa kohë do t'ju duhet pasi të
24 keni marrë listën e përditësuar. Kjo do të varet sigurisht
25 nëse është një përditësim i përgjithshëm apo secila jepet në

1 veçanti, çdo material në veçanti.

2 Z. AOUINI: [Përkthim] I nderuar Gjykatës ne pjesën e parë
3 e kemi bërë përmes një tablele me Excel. Në qoftë se marrim një
4 numër përditësimesh në grup do të ecim me shpejtësinë e mundur
5 për të zgjedhur ato të cilat janë me interes për neve.

6 Për sa i përket njoftimit tërësor ne kemi patur në
7 përgjithësi një periudhë 4-6 javore. Ne besojmë që na duhen 2
8 javë, që është gjysma e këtij afati kohor. Ne i kemi shqyrtuar
9 një numër syresh por na duhet t'i analizojmë edhe një herë me
10 sy tjetër. Prandaj do të na duhen 2 javë për të analizuar këtë
11 listë të përditësuar. Pra këto dy javë do të ishin të
12 mjaftueshme.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Aouini.
14 z. Prokuror a keni gjë për të shtuar?

15 Z. AOUINI: [Përkthim] Ju kërkoi ndjesë edhe një gjë
16 tjetër, i nderuar Gjykatës.

17 Mbetet një çështje e pazgjidhur të cilën po e diskutojmë
18 me ZPS-në. Nuk kanë dhënë një numër materialesh që kemi
19 zgjedhur pasi janë pjesë e dokumenteve të tjera. Janë
20 duplikime të dokumenteve të tjera dhe vazhdojnë diskutimet me
21 ZPS-në për t'ua bërë të qartë se cilat janë ato dokumente të
22 cilat janë të duplikuar, duplikata përndryshe.

23 Kjo do të na ndihmonte pra me dokument të cilat nuk janë
24 të përshkuar në plotësi, kur janë vetëm pjesë-pjesë dhe kjo do
25 të na ndihmojë për ta përshpejtuar procesin, për ta bërë sa më

1 të efektshëm që të jetë e mundur.

2 Doja që ta thoja këtë për procesverbalin.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Gjëra e fundit për këtë
4 pikë.

5 Palët a mendojnë se mund ta zgjidhin këtë çështje *inter*
6 *partes*? A mendoni që do të jeni në gjendje që t'i përmbushni
7 kërkesat e Mbrojtjes për sa i përket saktësisë së përshkrimit
8 dhe nga ana tjetër, a prisni ju që Prokuroria t'u japë
9 informacionin e duhur të mjaftueshëm dhe në kohën e duhur me
10 qëllim që t'i përfundoni hetimet tuaja brenda një afati të
11 arsyeshëm kohor.

12 z. Prokuror.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës,
14 kërkesat e Mbrojtjes kanë qenë të arsyeshme deri më tani dhe
15 nuk arsye të besojmë që nuk do të mund të japim një përgjigje
16 po aq të kënaqshme.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

18 Z. Aouini.

19 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.

20 Lajmi i mirë që ka ndryshuar të tërë diskutimin ishte ai
21 që erdhi sot, pra kur ZPS-ja ra dakord që t'i përditësonte
22 këto përshkrime. Dhe ne besojmë që kjo është në përputhje me
23 vendimin tuaj. Jemi optimistë që do ta zgjidhim këtë çështje.
24 Pra jemi të bindur që do të arrijmë rezultatin tonë.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Aouini.

1 Të tregohemi optimistë sidomos për sa i përket periudhës
2 që kërkohet për përditësimin e përshkrimit të këtyre 17,000
3 dokumenteve. Dhe po i hedh sytë zyrtarëve që janë në bankën e
4 fundit aty pasi ne do të varemi pikërisht nga efektshmëria e
5 punës së tyre.

6 Të kalojmë tani tek materialet e rregullës 103.

7 ZPS-ja ka thënë që nuk e kishte përfunduar analizën e të
8 tërave dokumenteve të rregullës 102(3), për të parë nëse ka
9 materiale shfajësuese, porse ata ishin gati për ta përfunduar
10 këtë punë përpara ditës së sotme.

11 Dhe prandaj po i kërkoj ZPS-së që të na përditësojë me
12 këtë punë dhe shpresoj që mund të konfirmojnë se e përfundojnë
13 këtë rishqyrtim të materialeve shfajësuese.

14 I kërkoj ZPS-ë po kështu të tregojë nëse kërkohen masa
15 mbrojtëse për këtë kategori materialesh, duke pasur parasysh
16 se në parashtrimet me shkrim ka thënë se dëshironte që të
17 bënte një gjithëpërfshirëse për masa mbrojtëse pasi ta kishte
18 përfunduar këtë analizë.

19 Dhe në fund i kërkoj ZPS-ë të tregojë nëse ka materiale
20 të tjera shfajësuese të cilat duhet t'i jepen palës mbrojtëse.

21 Prokurori ju e keni fjalën.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Përpara se të filloj, i nderuar
23 Gjykatës, diçka sa për ta korigjuar procesverbalin.

24 Përshkrimet nuk janë 17,000 por janë 1700 jam i sigurt që ju e
25 keni kuptuar i nderuar Gjykatës por këtu ka një numër shumë më

1 të madh dhe desha ta sqaroja që ishte 10 herë më e ulët
2 shifra.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ndoshta frikësova të tërë
4 kur thashë 17,000 dhe kjo nënkupton tashmë që do të jemi 10
5 herë më të shpejtë dhe përshpejtojmë të gjithë procedurën.

